



Letrat intime dhe kuptimi i misionarizmit të Nënë Terezës

Description

Rezart Beka

Shenjtërimi i Nënë Terezës është planifikuar të shpallet nga autoritetet e Vatikanit në 4 shtator 2016. Kjo ngjarje ofron një rast tejet të volitshëm për të formuar një përshtypje sa më objektive rreth personit të Nënë Terezës, vokacionit të saj fetar dhe natyrës së misionit të saj bamirës. Në vitin 2007 At Brian Kolodiejchuk, përgjegjësi (postulatori) i çështjes për lumturimin dhe kanonizimin e Nënë Terezës së Kalkutës botoi një prej librave më të rëndësishëm për Nënë Terezën të titulluar “Mother Teresa: Come Be My Light” (Nënë Tereza: Eja bëhu drita ime)[1]. Autori e ka përgatitur librin në kuadrin e mbledhjes së të dhënave për shenjtërinë e Nënë Terezës dhe paraqitjen e tyre për shqyrtim pranë Kongregacionit mbi Çështjet e Shenjtorëve. Për përgatitjen e librit autori ka shqyrtuar shënimet e ditarit të Nënë Terezës, si edhe më se gjashtë mijë letra personale, dhe letërkëmbimin që ajo ka patur me rrëfyesit e saj, udheheqësit shpirtërorë dhe teologë të ndryshëm[2].

Pavarësisht rëndësisë vendimtare që ky libër ka për të kuptuarit sa më të drejtë të jetës dhe veprës së Nënë Terezës, për sa kam dijeni libri mbetet ende i pabotuar në gjuhën shqipe. Publikimi dhe komentimi që At Kolodiejchuk i ka bërë letrave intime dhe letërkëmbimeve më të rëndësishme të Nënë Terezës përbën një nga rastet e rralla ku lexuesi apo studiuesi pajiset me material të dorës së parë ku vetë personaliteti në fjalë rrëfen, përshkruan apo paraqet vetë identitetin dhe dimensionet e tij më intime. Kësodore, analiza e përmbledhur e letrave intime të Nënë Terezës, ashtu siç shfaqen në librin e përgatitur nga At Kolodiejchuk, është mënyra më ideale për të kuptuar jetën e brendshme, objektivat dhe synimet e Nënë Terezës në themelimin e misionit të saj bamirës, si edhe kornizën teologjike që qendronte në themel të mënyrës se si ajo i jepte trajtë identitetit të saj si murgeshë dhe se si e konceptonte veprën e saj si misionare.

Në konspektin që ne i bëjmë librit të At Kolodiejchuk do të kufizohemi në të hedhurit dritë mbi disa prej aspekteve kyçe të personalitetit dhe veprës së Nënë Terezës, dhe do të orvatemi t'i përgjigjemi pyetjeve të tilla si: Si e konceptonte Nënë Tereza veprën e saj bamirëse? Cili ishte objektivi fundor i misionit të saj bamirës? Si e shihte ajo rolin e saj në vokacionin shpirtëror që ndjente se ishte thirrur për ta përmbushur? Cila ishte korniza teologjike që qendronte në themel të punës së saj misionare? Në çfarë marrëdhënieje qendrojnë përkatësia etnike dhe vizioni teologjik i cili determinonte punën bamirëse dhe identitetin e saj fetar? Ku e shihte Nënë Tereza veçanësinë e punës së saj bamirëse në krahasim me përpjekje të ngjashme bamirësie të mbështetura në vizione laike apo humaniste?

Qëllimi i Misionit

Vokacioni misionar dhe shpëtimi i shpirtave

Nënë Tereza rrëfen se një nga dëshirat e saj të vazhdueshme që në moshën pesë vjeçare kishte qenë ajo për të shpëtuar shpirta duke u mundësuar atyre që të njohin dhe të pranojnë Krishtin. Në një rast tjetër, ajo pohon se vokacioni për t'u shërbyer të varfërve i është shfaqur në moshën dymbëdhjetë vjeçare, ku për herë të parë i lindi dëshira për të qenë një misionare dhe për të "dhuruar jetën e Krishtit te njerëzit në vendet e misionit"[3]. Me këtë ndjenjë të fortë misionarizmi dhe dëshire për të përhapur Krishtin nëpër botë, në shtator të vitit 1928, në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, Nënë Tereza nis për në Irlandë për t'u bërë pjesë e Institutit të së Lumes Zojë, njohur ndryshe si "Motrat e Loretos" dhe në dhjetor të po atij viti nis për në Indi "me shpresën që të shpëtoj sa më shumë shpirta"[4]. Rrugës për në Indi Nënë Tereza i shkruan të afërmëve të saj: "Lutuni për misionaren tuaj në mënyrë që Jezusi të mund ta ndihmojë atë që të shpëtojë sa më shumë shpirta të pavdekshëm që të jetë e mundur nga skëterra e mosbesimit"[5]. Përgjatë udhëtimit të gjatë për në Indi Nënë Tereza shkruan një poezi ku, ndër të tjera, i drejtohet Perëndisë duke thënë:

"O Zot, pranoje këtë blatim

Si shenjë e dashurisë sime

Të lutem, ndihmoje krijesën tënde[6]

Që të përlevdojë emrin Tënd!

Në shkëmbim të kërkojë vetëm Ty

O Ati ynë, kaq i Mirë:

Më bëj të mundur që të shpëtoj të paktën një shpirt[7].

Mbas mbërritjes në Indi, Nënë Tereza dërgohet në Darjeeling për të përmbushur noviciatin e saj, dhe, pas kryerjes së kushteve të përkohshme, në vitin 1931, dërgohet në komunitetin e motrave të Loretos në Kalkutë ku caktohet të japë mësim në shkollën bengaleze për femra Saint Mary. Në vitin 1937, Nënë Tereza mori kushtet e përhershme dhe zgjodhi të përvetësojë emrin e Shën Thérèse nga Lisieux, shenjte dhe mbrojtëse e misionarëve. Megjithëkëtë, momenti më vendimtar për aktivitetin misionar të Nënë Terezës vjen në 10 shtator të vitit 1946, ku, sipas dëshmisë së saj, gjatë një udhëtimi me tren ajo përjeton një takim mistik me Jezusin, në të cilin ai e fton atë që të lërë urdhërin e motrave të Loretos dhe të shuajë etjen e tij për dashuri dhe shpirta duke e ndjekur atë “në lagjet e varfra dhe për t’i shërbyer atij te më të varfërit e më të varfërve”[8]. Kjo thirrje të cilën Nënë Tereza e quante “dita e frymëzimit” konsiderohet prej saj si dita e themelimit të urdhërit të saj “Misionaret e Dashurisë”.

Etja e Jezusit i referohet atij çasti të kalvarit të Krishtit ku, sipas ungjijve, ndërsa jepte shpirt në kryq Jezusi thirri “Kam etje” (Gjoni 19:28). Për Nënë Terezën këto fjalë të Jezusit në kryq duheshin interpretuar si etja e Hyut Jezus për dashuri dhe shpirta njerëzorë dhe ajo do ta shihte qëllimin përfundimtar të misionit të saj bamirës pikërisht në shuarjen e etjes së Jezusit. Siç shprehet edhe vetë ajo: “Për mua është shumë e qartë: Gjithçka prej misionareve të dashurisë ekziston vetëm për të shuar etjen e Jezusit”[9]. Urdhëri “Misionaret e dashurisë”, i themeluar nga Nënë Tereza, do të konceptohej pikërisht si një shërbim i përunjur ndaj thirrjes së Krishtit përmes të cilit misionaret e Nënë Terezës përpiqeshin “të dërgonin shpirtat te Perëndia dhe Perëndinë te shpirtat”[10] Sipas saj, në të njëjtën mënyrë sikundër engjëjt e parajsës përlëvdojnë pafundësisht Hyun Jezu Krisht ashtu edhe motrat e Nënë Terezës, përmes shërbimit të tyre ndaj të varfërve, shuajnë etjen e Zotit “përmes dashurisë së tyre dhe dashurisë për shpirtat që dërgojnë tek Ai”[11].

Ky sens misionarizmi dhe prozelitizmi është qartësisht i dukshëm edhe te rregullat e urdhërit, të hartuara nga vetë Nënë Tereza. Sipas këtyre rregullave “qëllimi përfundimtar i Misionareve të dashurisë është shuarja e etjes së Jezu Krishtit në Kryq për dashuri dhe shpirta”[12]. Ndërsa qëllimi specifik i misionit të urdhërit përshkruhet si “dërgimi i Krishtit në shtëpitë dhe rrugët e lagjeve të varfra, në gjirin e të sëmurëve, atyre që janë duke vdekur, lypsarëve dhe fëmijëve të rrugës”[13]. Synimi për të shuar etjen e Krishtit duke i dërguar sa më shumë shpirta të jetë e mundur shihet qartë edhe në shpjegimin që Nënë Tereza u jep veprave që urdhëri i saj duhej të kryente ndërmjet skamnorëve të qyteteve.

Në rastin e hapjes së shkollave për fëmijët e vobektë, Nënë Tereza shpjegon se pas përkujdesit për nevojat fizike dhe arsimore të fëmijëve, Misionaret e Dashurisë duhet t’u mësojnë atyre “lutje të shkurtra dhe si ta duan Perëndinë... Do t’i përgatisin për sakramentet, kurse të dielën do t’i dërgojnë në Kishë”[14]. Për sa i përket përkujdesjes për të sëmurët në shtëpitë e tyre, ajo shprehet se përveç përkujdesjes fizike, motrat e Nënë Terezës duhet të “inkurajojnë të sëmurët... që të marrin kungimin e shenjtë. Për ta kryer këtë, ato duhet të sjellin me vetë gjithçka që është e nevojshme për të përgatitur të sëmurin dhe dhomën e Tij për ardhjen e Jezu Krishtit. Do t’i komunikojnë në kohë priftit se sa njerëz ka që dëshirojnë të pranojnë Jezu Krishtin”. Siç shprehet edhe vetë Nënë Tereza, “dëshira ime dhe e motrave të mia është të sjellim Krishtin në “vrimat” e palumtura të lagjeve të varfra të Kalkutës së skamnorëve, dhe më pas të bëjmë [të njëjtën gjë] edhe në vende të tjera”[15]. Më fjalë të tjera, misioni i Nënë Terezës dhe Misionareve të Dashurisë konsistonte në “sjelljen e dashurisë së Krishtit në gjirin e më të varfërve duke bërë të mundur në këtë mënyrë që ata ta njohin dhe ta duan Krishtin në jetët e tyre të palumtura”[16].

Në letrat e saj Nënë Tereza i koncepton shtëpitë apo fondacionet që kishte themeluar nëpër botë si tabernakuj, nga ku ajo dhe motrat e saj misionare do të mund të përhapnin aromën e Krishtit ndër

njerëz, dhe të bënin të mundur dërgimin e shpirtave tek Jezusi[17]. Vite më vonë, me rastin e pesë vjetorit të themelimit të kongregacionit të saj “Misionaret e Dashurisë”, Nënë Tereza i shkruan kryepeshkopit Périer duke shprehur gëzimin e saj për faktin se, falë misionit të saj, “shpirta të shumtë janë dërguar te Zoti”[18] dhe se si ajo dhe motrat e saj u kanë mësuar të varfërve dhe atyre në prag të vdekjes që të duan dhe të vuajnë për Hyun Jezu Krisht. Tema e konvertimit shfaqet qartë edhe në fjalimin solemn që kryepeshkopi Périer mbajti me rastin e themelimit zyrtar të kongregacionit “Misionaret e Dashurisë” të Nënë Terezës. Gjatë fjalimit ai rikonfirmon edhe njëherë se qëllimi përfundimtar i kongregacionit të themeluar nga Nënë Tereza është “shuajtja e etjes të Hyut tonë Jezu Krisht për shpëtimin e shpirtave...” dhe shpjegon se motrat e Nënë Terezës kanë për detyrë të përkujdesen për njerëzit në nevojë, t’u mësojnë atyre doktrinën e krishterë dhe të bëjnë “çmos për konvertimin dhe shenjtërimin e tyre”[19].

Sipas dëshmisë së Nënë Terezës, po në ditën e takimit mistik me Jezusin, ajo filloi të dëgjonte për së brendshmi, për disa muaj radhazi, zërin e Jezusit, ku ky i fundit i bënte vazhdimisht të ditur dëshirën e tij për të dhe natyrën e misionit për të cilin ajo ishte thirrur. Sipas Nënë Terezës, zëri i Jezusit e thërriste që të braktiste urdhërin e Motrave të Loretos dhe të shkonte në lagjet e varfra e të shpëtonte shpirtat e të varfërve duke sakrifikuar veten e saj në përkujdesjen për skamnorët, ata që ishin duke vdekur, lypësit dhe të sëmurët[20].

Për Nënë Terezën, ndërkohë që urdhrat fetarë katolikë merreshin kryesisht me njerëzit e pasur dhe të aftë fizikisht, të sëmurët, të dobët e të varfërit liheshin në mëshirën e fatit. Në këtë mënyrë, sipas saj, ata jetonin nën sundimin e djallit[21], të “përlyer në mëkat”[22], në “skëterrën e mosbesimit”[23]. Me pak fjalë, sipas Nënë Terezës, nëpër Indi ekzistonin “milion njerëz” që jetonin jashtë shpëtimit “duke mos ditur asgjë për Zotin dhe Krishtin, në një gjendje të neveritshme mëkati”[24]. Ne, shprehej ajo, “do të dërgojmë Krishtin tek ata, dhe ata te Krishti”[25]. Ajo e shihte misionin e saj si një përpjekje për të qenë drita e Krishtit në lagjet e varfra, për ta dërguar Krishtin në “vrimat e palumtura”[26] të shtëpive të varfra duke u sakrifikuar për hir të Tij në shërbim të të vobektëve dhe nevojtarëve. Nënë Tereza ishte e bindur se falë punës bamirëse dhe vetësakrifikuese të saj dhe të misionareve të dashurisë, Jezusi do të mund të hynte në “shtëpitë e errta dhe të palumtura” të skamnorëve. Në këtë mënyrë, njerëzit do të kishin mundësinë që ta njihnin dhe ta dëshironin Jezusin në jetët e tyre duke siguruar, kështu, shpëtimin e përjetshëm.

Sipas rrëfimit të Nënë Terezës, vetë zëri i Jezusit i ishte drejtuar njëherë duke i thënë:

“E vogla ime, jepmë shpirta, shpirtat e fëmijëve të gjerë të rrugës. Sikur ta dije se sa të dhemb kur sheh këta fëmijë të përlyer në mëkat. Sikur t’i përgjigjeshe thirrjes Time e të m’i dërgoje Mua këto shpirta duke i shpëtuar nga kthetrat e të ligut (djallit)! Sikur ta dije se sa fëmijë të vegjël bien çdo ditë në mëkat!”[27].

Sipas saj, në një tjetër rast zëri i ka thënë:

“Sa dhembje të shkakton kur sheh këta fëmijë të përlyer në mëkat [...] Ata nuk më njohin, prandaj edhe nuk më duan [...] Sa shumë dëshiroj të hyj në “vrimat” e tyre, në shtëpitë e tyre të errëta e të palumtura. Eja, bëhu viktimë për ta! Në flijimin tënd, në dashurinë tënde për Mua ata do të më shohin, do të më njohin dhe do të më duan”[28].

Një tjetër herë zëri i është drejtuar me fjalët:

“Vokacioni yt është të dashurosh, të vuash dhe të shpëtosh shpirtra. Duke kryer këtë hap, ti do të realizosh dëshirën e Zemrës Sime për ty. Ky është vokacioni yt”[29].

Prozelitizimi, i shprehur nën kornizën konceptuale të shpëtimit të shpirtrave, dhe rëndësia që kjo kishte për misionin e Nënë Terezës shfaqet më së miri në përshkrimin që ajo i dha kryepeshkopit Périer rreth tre vegimeve të përjetuara prej saj. Sipas saj në vegimin e parë ajo kishte parë një turmë të madhe njerëzish të çdo lloji që i kishin ngritur duart drejt saj duke thirrur: “Eja, eja na shpëto! Na dërgo tek Jezusi!”. Në vegimin e dytë ajo kishte parë të njëjtën turmë njerëzish, me shenja të qarta dhimbjeje dhe vuajtjeje në fytyrat e tyre. Vetë Nënë Tereza qendronte e gjunjëzuar para Shën Mërisë, e cila i thoshte: “Kujdesu për ata: ata janë të mitë. Dërgoju tek Jezusi dhe dërgoje Jezusin tek ata. Mos u druaj. Mësoju atyre që të recitojnë rruzaren në familje dhe gjithcka do të shkojë mirë. Mos druaj, Jezusi dhe unë do të jemi me ty dhe fëmijët e tu”. Në vegimin e tretë Nënë Tereza sheh të njëjtën turmë të mbuluar nga terri. Jezusi ndodhet në kryq dhe Shën Mëria pak më larg, ndërsa Nënë Tereza qendron para saj. Në këtë moment Jezusi i drejtohet duke thënë: “Unë ta kam kërkuar, ata ta kanë kërkuar, dhe ajo, nëna ime, ta ka kërkuar. Mos vallë do të refuzosh ta bësh këtë për mua, të kujdesesh për ta dhe t’i dërgosh tek Unë?” Në këtë moment, Nënë Tereza i përgjigjet: “Ti e di, Jezus, se jam gati të nisem menjëherë”[30].

Ky konceptim pesimist i gjendjes aktuale të atyre që nuk e njohin Jezusin dhe rolit që Nënë Tereza është thirrur të luajë në shpëtimin e tyre, duke shuar etjen e Krishtit për shpirtra, ishte në themel të mënyrës së si ajo e konceptonte misionin e saj. Në letrat e Nënë Terezës, jo të krishterët e Kalkutës, por veçanërisht të varfërit dhe të dobëtit përshkruhen si të privuar nga shpëtimi, të humbur, të palumtur, “nën kthetrat e djallit”, në “gjendje të neveritshme mëkati” dhe të zhytur në “skëterrën e mosbesimit”, si edhe në nevojë të menjëhershme për t’u njohur me dritën e sjellë nga Krishti. Prej këndej vjen edhe ndjesia e saj e nevojës urgjente për mision te jo të krishterët dhe dëshira e zjarrtë për të luftuar për shpirtrat e njerëzve. Aktiviteti misionar konceptohet si mënyra e vetme për të dërguar shpëtimin e sjellë nga Jezusi te masat e njerëzve që jetojnë në errësirë dhe keqduhëzim. Aktiviteti bamirës i Nënë Terezës është në funksion të kësaj kornize më të gjerë teologjike, e cila determinon këndvështrimin e saj metafizik dhe rolin misionar që ajo mendonte se ishte thirrur për ta përmbushur.

Një teologji e tillë ka qenë tejet e zakonshme për misionarizmin e krishterë të periudhës para Koncilit të dytë të Vatikanit (1963-1965). Ajo mbështetej deri diku mbi një këndvështrim ekskluzivist të teologjisë së feve të krishterë, i cili qendronte mbi tre parime kryesore[31]: 1) *solus Christus*, d.m.th. bindja se Krishti është dërguar për shpëtimin e njerëzimit dhe se ky i fundit nuk arrihet vetëm se përmes besimit në Krisht; 2) *fides ex auditu*, bindja se besimi në Krisht bëhet i mundur vetëm përmes dëgjimit dhe pranimit të fjalës së Zotit në Bibël; 3) *extra ecclesiam nulla salus*, bindja se jashtë trupit të Kishës nuk ka shpëtim dhe se çdokush i cili nuk aderon në Kishë është i privuar nga shpëtimi përfundimtar[32]. Megjithatë, Koncili i Dytë i Vatikanit (1963-1965) përvetësoi një qasje inkluziviste karshi feve të tjera sipas së cilës Kisha katolike njih dhe përnderon çdo predikim, të vërtetë apo të shenjtë, që gjendet tek ato, duke pohuar se “reflektojnë një rreze të asaj të Vërtetë që ndriçon të gjithë njerëzit”[33], ngaqë në fetë dhe kulturat jo të krishtera janë mbjellur “farërat e Fjalës”[34], e kësaj “çfarëdo elementi i të vërtetës dhe hirit që gjendet midis kombeve” duhet konsideruar si “një lloj pranie e fshehtë e Zotit”[35]. Sipas dokumenteve konciliare kjo bën të mundur që ndjekësit e këtyre feve “të rreshtohen në Popullin e Zotit”[36] në mënyra të ndryshme dhe të përfshihen në këtë mënyrë në planin shëlbues të Tij, duke qenë se “Shëlbuesi do që të gjithë njerëzit të shëlbohen”[37]. Madje në rastin e atyre që pa faj nuk arrijnë të njohin Ungjillin por megjithatë përpiqen të kërkojnë Zotin dhe të kryejnë vullnetin e Tij, atëherë fetë apo sistemet e jetës në të cilin ata aderojnë mund të shërbejnë në vetvete si rrugë të

vlefshme shpëtimi për arritjen e shëlbimit të amshuar[38].

Ky ndryshim paradigmatic në teologjinë katolike të misionit solli largimin e misionarizmit të krishterë nga një lloj qasjeje të mbyllur dhe përjashtuese ndaj feve, kulturave apo parimeve etike të popujve të misionit, si edhe nga prirja prozelituese agresive që karakterizonte shumë misione të krishtera në periudhën para-konciliare. Qasja ekskluziviste u konsiderua nga etërit konciliar si e papërshtatshme për jetën moderne të karakterizuar nga multifetarizmi dhe multikulturalizmi. Ajo u pa si një pengesë për vendosjen e urave lidhëse dhe bashkëpunimit ndërmjet feve dhe kulturave të ndryshme dhe garantimit sa më të mirë të një jetese të përbashkët. Ekskluzivizmi u konsiderua, gjithashtu, një pengesë për vendosjen e themeleve të shëndosha të dialogut ndërfetar i cili shihej nga etërit konciliar si mënyra e vetme për të garantuar paqen dhe prosperitetin ndërmjet feve. Në vend të kësaj, teologjia post-konciliare e misionit përvetësoi një qasje pozitive ndaj burimeve etiko-shpirtërore të popujve të misionit dhe filloi ta konceptonte veprën e misionit si vendosjen e një marrëdhënieje dialektike dhe një angazhimi pozitiv me fetë dhe kulturat e tjera. Teologjia e misionit e Nënë Terezës u formësua kryesisht në periudhën para-konciliare dhe përgjatë viteve ruajti të pandryshuara karakteristikat e saj ekskluziviste. Në letrat e saj Koncili i Dytë i Vatikanit ka kaluar pothuajse i pavërejtur, dhe nuk ka luajtur asnjë rol domethënës në farkëtimin e konceptimit të misionit. Përgjatë gjithë jetës ajo i mbeti besnike vizionit fillestar karshi misionarizmit, të formuluar në vitet '40-50 të shekullit të kaluar.

Transcendimi i tipareve të veçanta etniko-kombëtare dhe identifikimi me të vafërit

Në Indinë e viteve '30-40 të shekullit të kaluar ekzistonin shumë urdhëra të tjerë misionarë të krishterë, por sipas Nënë Terezës këto urdhëra fetarë nuk përkujdeseshin për të varfërit dhe njerëzit e rrugës, përkundrazi ato fokusoheshin vetëm te shtresat e pasura apo njerëzit fizikisht të aftë. Ato nuk shkonin te njerëzit, por prisnin që njerëzit të shkonin tek ato. Shumica e misionareve të pranishme në këto kongregacione ishin me origjinë evropiane, dhe, paçka përpjekjes për t'u adaptuar me kulturën vendase, ato mbeteshin gjithsesi të huaja. Madje edhe misionaret indiane, që bëheshin pjesë e këtyre urdhrave fetarë, përvetësonin stilin, zakonet, veshjen dhe kulturën e murgeshave evropiane duke u shndërruar, në këtë mënyrë, në të huaja për vendin e tyre[39]. Duke pasur parasysh këto mangësi në thirrjen misionare të asaj kohe, Nënë Tereza ishte e mendimi se misionaret e urdhërit të themeluar prej saj duhej të arrinin në zemrat e njerëzve dhe të ishin drita dhe zjarri i dashurisë së Krishtit për të marginalizuarit përmes identifikimit të plotë me të varfërit, të sëmurët dhe të dobët. Ato duhet të hiqnin dorë nga tiparet e veçanta kombëtare, etnike dhe kulturore të vendeve të tyre të origjinës, dhe të përvetësonin në gjithçka stilin e jetës së njerëzve skamnorë të cilëve ato u shërbenin. Vetëm duke u bërë të njëjtë në gjithçka me njerëzit të cilëve ato u shërbenin, misionaret e Nënë Terezës do të mund të dërgonin në mënyrë autentike "Krishtin në "vrimat" e palumtura të lagjeve të varfra të Kalkutës"[40]

Siç shprehet edhe vetë Nënë Tereza: “[Zoti më thërret] që të jem indiane, të jetoj me ta, dhe, si ata, të arrij [në këtë mënyrë] në zemrat e njerëzve”[41]. Në një rast tjetër, ajo shprehet: “Zoti ynë [Jezu Krishti] dëshiron murgësia indiane... që të jetojnë jetën e indianëve, të vishen si ata, të jenë drita e tij, zjarri i tij i dashurisë ndër të varfërit, ndër të sëmurët, ndër ata që janë në prag vdekje, ndër lypësit dhe fëmijët e rrugëve”[42]. Menjëherë pas këtij shpjegimi, Nënë Tereza shprehet se: “Unë dua të kënaq këtë dëshirë të Zotit tonë [Jezu Krishti] duke u bërë indiane dhe duke jetuar në këtë mënyrë për hir të tij dhe të shpirtave të të varfërve”[43]. Ky transcendim i tipareve të veçanta kombëtare, etnike apo kulturore dhe identifikimi i plotë me jetën e njerëzve të cilëve u shërbej shihet qartë edhe në faktin se Nënë Tereza përzgjedhi si veshje zyrtare të kongregacionit të saj veshjen tradicionale indiane “sari”[44]. Zgjedhja e sarit indian si veshja e misionareve të dashurisë, të themeluar nga Nënë Tereza, ishte shprehja e drejtpërdrejtë e idesë së saj për transcendimin e partikulariteteve etniko-kulturore dhe identifikimin e plotë me të varfërit dhe të marginalizuarit të cilëve u shërbej.

Theksimi i identiteteve të orgjinës nga misionaret e dashurisë do të nënkuptonte rënien në të njëjtin gabim të urdhërave të tjerë misionarë dhe pamundësinë e dërgimit të Krishtit në lagjet e varfra dhe të njerëzit e marginalizuar. Narrativa e zhvilluar në Shqipëri rreth Nënë Terezës çalon pikërisht në faktin se ajo përpiqet të bëjë qendror elementin e origjinës apo përkatësisë etnike të Nënë Terezës të cilin vetë ajo e shihte si një pengesë për përmbushjen sa më të mirë të misionit të saj fetar. Në perspektivën e Nënë Terezës përkatësia e saj etnike apo e motrave të saj nuk është thirrur të luaj asnjë rol domethënës në zhvillimin e misionit tek jo të krishterët. Përkundrazi, zhveshja nga partikularitet etniko-kulturore dhe identifikimi në gjithçka me traditat dhe zakonet e popujve të cilëve i shërbej shihet si qasje qendrore për përmbushjen e misionit dhe dërgimit të Krishtit tek të varfërit dhe të marginalizuarit.

Shenjtoria e errësirës: Pjesëmarrja në planin shëlbyes të Krishtit dhe identifikimi me të varfërit

Pas një kohe të gjatë përpjekjesh nga ana e Nënë Terezës, më në fund në 7 tetor 1950, pas lejes së dhënë nga autoritetet e Vatikanit, kyepeshkopi Périer sanksionoi zyrtarisht themelimin e kongregacionit “Misionaret e Dashurisë”. Pothuajse menjëherë pas fillimit të punës në lagjet e varfra të Kalkutës dhe deri në fund të jetës së saj, Nënë Tereza filloi të përjetojë një krizë të thellë shpirtërore. Në letrat e saj, të shkruara përgjatë viteve, ajo shprehet për ndjesinë e vetmisë së thellë që ndjente në shpirtin e saj, për terrin dhe ftohtësinë e akullit që mbizotëronte brenda saj. Shpesh ajo flet për ndjesinë e tmerrshme të zbrazëtisë që ndjente përbrenda dhe përjetimin e mungesës së plotë të Zotit në zemrën e saj. Sipas përshkrimit të dhënë nga vetë ajo, shpirti i saj ndodhej në një gjendje humbjeje, mungese të Zotit, vetmie dhe vuajtjeje të vazhdueshme. Ajo e shihte veten të paaftë të lutej, të ndjente kënaqësinë e adhurimeve dhe të përjetonte praninë e Zotit[45].

Në një letër shkruar Jezusit dhe dërguar At Picachy-t në 3 Korrik të vitit 1959, ajo ndër të tjera thotë:

“Unë dua...dhe nuk ka asnjë që të përgjigjet, askush tek i cili mund të kapem, jo, askush. Jam vetëm. Errësira është kaq e dendur dhe unë jam vetëm, e padëshiruar, e braktisur... Ku është besimi im? Edhe thellë brenda, nuk ka asgjë veçse boshllëk dhe errësirë... Nuk kam besim... Kur përqipem t'i ngre mendimet e mia drejt Qiellit, ekziston një boshllëk që më ndëshkon, kaq shumë sa që vetë këto mendime kthehen mbi mua si tehe të mprehta dhe më plagosin shpirtin. Dashuri... Kjo fjalë nuk ngjall asgjë [tek unë]. Më thuhet se Perëndia më do, e megjithatë realiteti i errësirës, i të ftohtit dhe i zbrazëtirës është kaq i madh sa që asgjë nuk e prek shpirtin tim[46].

Në një tjetër letër drejtuar Jezusit dhe dërguar At Picachy në 3 shtator të vitit 1959, ajo përshkruan krizën e saj shpirtërore duke thënë:

“Në shpirtin tim ndjej atë ndjenjë të tmerrshme humbjeje, që Zoti nuk më do, që Zoti nuk është Zot, që Ai nuk ekziston në të vërtetë...Kjo errësirë më rrethon nga çdo anë. Nuk arrij ta ngrej shpirtin tek Zoti. Asnjë dritë dhe asnjë frymëzim nuk hyn në shpirtin tim...Nga buzët e mia dalin fjalë tek të cilat dëshiroj të besoj me një dëshirë të thellë e të zjarrtë. Për çfarë lodhem? Nëse nuk ka Zot, nuk mund të ketë as shpirt. Nëse nuk ka shpirt, atëherë edhe ti Jezus nuk je i vërtetë. Qiell... çfarë zbrazëtie. As edhe një mendim i vetëm nuk hyn në mendjen time se nuk ka shpresë[47].

Në një tjetër letër këtë herë drejtuar At Neunerit diku nga viti 1960, Nënë Tereza rrëfëhet duke thënë:

“At, që nga viti 1949 apo 1950 përjetoj këtë ndjesi të tmerrshme braktisjeje, këtë errësirë të papërsosur, këtë vetmi... Errësira është e tillë që me të vërtetë nuk arrij të shoh, as me mendje as me arsye. Vendi i Perëndisë në shpirtin tim është i zbrazët: Nuk ka Zot në mua. Ai nuk më do, Ai nuk është këtu [...]. Qielli, shpirtrat: këto janë thjesht fjalë boshe për mua? Vetë jeta ime duket kontradiktore: unë ndihmoj shpirtrat, por për të shkuar ku? Përse e gjithë kjo? Ku është shpirti në qenien time. Zoti nuk më do”[48].

Megjithatë, shkrimet e Nënë Terezës lënë të kuptohet se, pavarësisht gjithë kësaj, dëshira për të mbetur në marrëdhënie me Zotin, nënshtrimi ndaj vullnetit të Tij dhe kryerja rigoroze e adhurimeve mbetën pika solide të jetës së saj. Gjithaq e patundur mbeti edhe bindja e saj se kishte qenë pikërisht Jezusi ai që e kishte thirrur të ndërmerre misionin, dhe se ky i fundit nuk ishte vepër e saj por e Jezusit, si edhe se ajo ishte thjesht një vegël në duart e Tij[49].

Pa dashur që të ofrojmë një vlerësim teologjik të përvojës mistike të Nënë Terezës ajo që merr rëndësi në këtë pikë është orvatja për të kuptuar se çfarë interpretimi i ka dhënë vetë Nënë Tereza krizës së saj shpirtërore, si edhe çfarë rëndësia ka pasur ky interpretim në mënyrën se si ajo e konceptonte veten e saj dhe punën e saj misionare.

Disa autorë katolikë janë përpjekur ta interpretojnë këtë gjendje shpirtërore të Nënë Terezës nën thjerrzën interpretuese të nocionit mistik katolik të “natës së errët të shpirtit” ose “natës së errët të shqisave”[50]. Ky nocion mistik, i formuluar në mënyrë të detajuar nga Shën Gjoni i Kryqit (1542-1591 e. s.) i referohet procesit të purifikimit dhe zbrazjes përmes së cilës shpirti duhet të kalojë në mënyrë që të shkëputet nga çdo atashim tokësor dhe të arrijë bashkimin me Perëndinë. Gjatë këtij procesi purifikimi radikal, drita dhe dashuria e plotë e Perëndisë i komunikohet shpirtit të varfër dhe të papërsosur njerëzor. Kjo bën që shpirti ta përjetojë këtë dritë hyjnore si vuajtje, errësirë, thatësi dhe mundim[51]. Në misticizmin katolik, nata e errët e shpirtit manifestohet me shenja të ndryshme, ku ndër to mund të përmendim paaftësinë e njeriut për ta adhuruar Zotin siç duhet, dhe pamundësinë e tij për të gjetur përmbushje dhe kënaqësi në gjërat e Zotit, ndjesinë e të qenit i padenjë për Të, i braktisur nga Ai, apo i destinuar për humbjen e përjetshme. Prej shenjave të natës së errët të shpirtit është edhe

ndjesia e dobësisë dhe pafuqisë të shpirtit njerëzor përballë soditjes hyjnore, si edhe e vuajtjeve të padurueshme që shkaktohen nga ndjesia e brendshme e errësirës e cila përjetohet sikur ndërthyer çdo hapësirë të shpirtit njerëzor. Megjithatë, ndonëse në mes të një lufte shpirtërore të mundimshme, gjithsesi njeriu mbetet i lidhur me Zotin dhe respektues i detyrave të tij fetare. Sipas këtij konceptimi mistik, nata e errët e shpirtit është një përvojë e përkohshme që shërben si një purifikues i shpirtit nga çdo atashim tokësor dhe shkëputje e tij nga gjerat e krijuara për t'i hapur rrugën, kësodore, bashkimit me Zotin[52].

Në vitin 1961, pothuajse njëmbëdhjet vjet pas fillimit të përjetimit të gjendjes së errësirës së shpirtit, Nënë Tereza pati një takim vendimtar me jezuitin Joseph Neuner. Pasi ajo i rrefeu gjendjen e saj shpirtërore, ky i fundit e pajisi atë me një kornizë teologjike të krishterë e cila në vijim do të përbente thelbin e mënyrës se si ajo e konceptonte veten dhe misionin e saj fetar. At Neuner ishte i mendimit se përvoja e Nënë Terezës i korrespondonte natës së errët të shpirtit. Për të, Nënë Tereza nuk vuante nga ndonjë mangësi shpirtërore, por ajo ishte thirrur që të përjetonte errësirën e brendshme si një shenjë bashkimi me errësirën dhe peshën e botës mëkatore që Jezusi u detyrua të mbaronte mbi vete për të shpëtuar botën nga humbja e përjetshme. Sipas tij, dëshira e Nënë Terezës për të qenë sa më pranë me Jezusin dhe për të përjetuar qoftë edhe një grimë të dritës së tij ishin prova se Zoti nuk e kishte braktisur, por i qendronte pranë më shumë se kurrë, ndonëse në mënyrë të fshehur dhe jo të drejtpërdrejtë[53]. Nënë Tereza e konsideroi mëse bindës këtë shpjegim dhe e përvetësoi atë si paradigmen teologjike qendrore mbi të cilën ajo do të bazonte identitetin e saj fetar dhe punën e saj misionare. Në një letër drejtuar At Neuner, ajo shprehet se “Për herë të parë në këto njëmbëdhjetë vjet kam arritur ta dua errësirën, sepse tani besoj që ajo është një pjesë, ndonëse shumë e vogël, e errësirës dhe e dhimbjes së Jezusit në Tokë”[54].

Në vijim Nënë Tereza e zgjeroi edhe më tutje bazën e kësaj intuente teologjike të ofruar nga At Neuner, dhe e shndërroi atë në çelësin e të kuptuarit të personit dhe aktivitetit të saj bamirës. Ajo filloi ta kuptonte vuajtjen e saj shpirtërore si një mënyrë për t'u identifikuar plotësisht me ata të cilëve ajo u shërbente. Përvoja shpirtërore e refuzimit, e zbrazëtisë, e errësirës, e mundimeve shpirtërore, e ndjesisë së mosbesimit, e mospranisë së Zotit, etj., interpretoheshin nga ajo si një mënyrë që Perëndia kishte zgjedhur që ajo të provonte në vetë të parë se çfarë përjetonin të varfërit, të dobët dhe të marginalizuarit që jetonin jashtë jetës në Zot, dhe në mjerim të thellë shpirtëror dhe fizik. Në këtë mënyrë ajo do të mund të identifikohet plotësisht me ata dhe do të mund të gjente forcat për të kryer misionin e saj misionar, që konsistonte në shpëtimin e tyre duke “sjellë Perëndinë në jetën e tyre dhe duke i dërguar ata tek Perëndia”[55]. Siç shprehet edhe At Kolodiejchuk : “Në planin e Perëndisë, asaj i ishte lejuar që të përjetonte një pjesë të realitetit të tmerrshëm të një jete pa Zot... Kjo përvojë ushqeu etjen e pashueshme të saj për të shpëtuar shpirtin duke ndihmuar çdo person që të njohë Zotin dhe dashurinë e Tij, dhe t'i riktheje dashurine Atij”[56].

Në kuadrin e kësaj kornize teologjike, ajo e konceptonte misionin e saj bamirës si pjesë përbërëse e shëlbimit (shpëtimit) të sjellë nga Jezusi. Sipas saj, ashtu siç Hyu Jezus kishte bërë të mundur shëlbimin (shpëtimin) e njerëzve duke u identifikuar plotësisht me ata, dhe duke marrë mbi vete mëkatën, vuajtjen dhe vdekjen, ashtu edhe ajo dhe motrat e saj misionare, njësoj si Jezusi, e vazhdonin misionin shëlbues të tij duke u identifikuar me të varfërit dhe të dobët, dhe duke marrë mbi vete një pjesë të vuajtjeve dhe mundimeve të tyre[57]. Përmes bashkëndarjes së vuajtjeve me të varfërit dhe sakrificës së tyre gjatë aktivitetit bamirës, misionaret e dashurisë do të mund të dërgonin dashurinë e Perëndisë te të marginalizuarit dhe do t'i shëlbënin (shpëtonin) ata nga mjerimi i tyre fizik dhe shpirtëror[58]. Në këtë mënyrë Nënë Tereza e integron veten në skemën e shpëtimit universal të Jezusit, duke e perceptuar misionin e saj si vazhdim të misionit shpëtues të Jezusit dhe si një instrument në duart e Tij për të mundësuar shpëtimin e të gjithë atyre që jetojnë jashtë jetës në Zot.

Kjo kornizë teologjike i mundësonte asaj që ta konceptonte natën e errët të shpirtit të saj si bashkëndarje e pasionit dhe vuajtjes shëlbyese të Krishtit. Ky besim përbënte për të “përvojën shëlbyese të jetës së saj”[59]. Ajo ishte e bindur se vuajtjet e saj shpirtërore ishin një mënyrë për të qenë pjesëmarrëse në pasionin e Krishtit dhe për t’u bashkuar në mënyrë misterioze dhe të pazgjydhshme me të”[60]. Ky pozicionim metafizik konceptohej prej saj si kuintesenca dhe burimi i kuptimit të gjithçkaje që ajo ishte dhe bënte

Për Nënë Terezën kjo kornizë teologjike përbënte thelbin e veçantësisë së punës së saj misionare, si edhe kuadrin konceptual kyç për të kuptuar identitetin dhe personalitetin e saj. Kjo perspektivë teologjike është pazgjydhshmërisht e lidhur me koncepte dhe doktrina bazë të krishtera, si triniteti, mëkati fillestar, mishërimi, hyjnia e Jezusit, kryqëzimi, shëlbimi dhe mbretëria e Perëndisë. Korniza teologjike që Nënë Tereza kishte përvetësuar si strukturë shpjeguese qendrore për të gjithë qenien dhe aktivitetin e saj bamirës presupozon vërtetësinë e këtyre koncepteve dhe doktrinave të krishtera. Ajo merr kuptim dhe është e kufizuar vetëm brenda perspektivës teologjike të krishterë. Për të, çdo interpretim i personit dhe aktivitetit të saj i cili nuk merr parasysh këtë konceptualizim teologjik në të cilin ajo e vendoste punën e saj misionare rezulton në një shtrembërim dhe keqinterpretim të figurës së saj. Për këtë arsye shpesh ajo nënvizonte dhe këmbëngulte mbi faktin se misioni i saj dhe i motrave të saj misionare nuk duhej interpretuar thjesht mbi suaza laike apo humaniste, përkundrazi, ndryshe nga aktivitetet e ngjashme bamirëse me sfond laik apo humanitar, aktiviteti i saj misionar konceptohej prej saj si vepër e Jezusit, si pjesë e shëlbimit të tij dhe pjesëmarrje në pasionin e Krishtit.

Kjo del qartazi në pah në një prej letrave ku ajo u drejtohet motrave të saja misionare duke thënë: “Bijat e mia, pa vuajtjen tonë vepra jonë do të ishte [thjesht] një vepër sociale. [Ajo do të ishte] e mirë dhe e dobishme, por nuk do të ishte vepra e Krishtit, nuk do të ishte pjesë e shëlbimit”[61]. Nënë Tereza i konceptonte shtëpitë e saj misionare si tabernakuj dhe dhurata të Zotit për botën që ka kaq shumë nevojë për Të, por që përsëri e refuzon Atë. Ajo i konceptonte shtëpitë e saj bamirëse si vende të shenjta ku motrat e saj misionare, pasi ushqeheshin me “Bukën e jetës”[62], shpërndaheshin nëpër botë për të gjetur Krishtin te të varfërit, të dobët dhe të margjinalizuarit. Aktiviteti i saj bamirës nuk ishte një objektiv në vetvete, por ishte në funksion dhe shërbim të kornizës teologjike të përvetësuar prej saj e cila bazohej te shëlbimi i Krishti. Ky ishte vizioni teologjik që qendronte pas punës së saj misionare. Prandaj ajo nuk reshtte së thëni: “Ne nuk jemi asistente sociale. Por jemi soditëse në zemër të botës. Jemi njëzet e katër orë në njëzet e katër me Jezusin”[63]. Në një moment ajo e përmbledh vizionin e saj metafizik për rolin e saj shpirtëror duke thënë: “Nëse ndonjëherë do të bëhem shenjto, do të jem me siguri një shenjto e errësirës. Do të mungoj vazhdimisht nga Parajsa për të nderur dritën e atyre që në Tokë jetojnë në errësirë”. [64]

Përmbyllje

Përmes letërkëmbimeve intime të Nënë Terezës jemi munduar që të hedhim dritë mbi aspektet e brendshme të personalitetit të saj dhe mbi këndvështrimin teologjik i cili gjendej në themel të aktivitetit të saj bamirës. Letrat e saj na prezantojnë me një figurë religjioze të preokupuar për përhapjen e krishterimit nëpër botë përmes aktivitetit të saj misionar dhe bamirës si edhe një figurë për të cilën lidhja e qenësishme me Krishtin dhe shëlbimin e tij, si edhe dëshira për t’i dhuruar atij gjithçka e për të mos i refuzuar asgjë[65], përbënin esencën e mënyrës se si ajo e konceptonte personin e saj dhe aktivitetin misionar. Misioni i saj ishte pazgjydhshmërisht i lidhur me kornizën teologjike në bazë të së cilës ajo e konceptonte veten si pjesëmarrëse në shëlbimin e Krishtit ndërsa aktivitetin e saj bamirës si një përpjekje për të shuar etjen e Krishtit për shpirtin duke e dërguar atë te shtresat e margjinalizuara dhe duke dërguar shpirtin e humbur tek ai. Vetëm në këtë mënyrë, mendonte ajo, njerëzit që nuk jetojnë në Zot do të mund të shpëtonin nga gjendja e neveritshme e mëkatit, mungesa e lumturisë, terri

i mosbesimit dhe mundimet e tmerrshme të botës së përtejme. Ajo i interpretonte vuajtjet e saj shpirtërore, që shenjtan qenien e saj për pjesën më të madhe të jetës, si një ftesë e Krishtit për të bashkëndarë me të kalvarin dhe pasionin e tij, dhe si një mundësi për t'u identifikuar me të marginalizuarit dhe për t'u shërbyer atyre në përpjekje për të ndriçuar dhe shenjtëruar me dritën e Krishtit jetët e tyre të palumtura.

Çdo narrativë rreth Nënë Terezës e cila anashkalon këtë kornizë teologjike përcjell domosdoshmërisht një shtrembërim dhe keqinterpretim të figurës së saj. Mosmarrja parasysh e aspektit teologjik të krishterë dhe rëndësisë qenësore që ky aspekt kishte për aktivitetin misionar të Nënë Terezës e zbrast figurën e saj nga cdo përmbajtje dhe e bën atë të cenueshme ndaj instrumentalizimit me sfond politik apo ideologjik. Të kufizuarit e paradigmës teologjike që frymëzonte punën e Nënë Terezës thjesht në një sfond dekorativ, dhe interpretimi i personit të saj në suaza krejt laike dhe humaniste bie ndesh me përshkrimin vetjak dhe konceptimin personal që Nënë Tereza kishte për personin e saj dhe punën e saj misionare. Identiteti i saj si murgeshë, shërbimi ndaj Kishës dhe përkushtimi ndaj shuarjes së etjes së Krishtit për shpirta përbënin themelet dhe esencën e mënyrës se si ajo e perceptonte personin dhe rolin e saj në botë. Shpresojmë që analiza jonë e letrave intime të Nënë Terezës të ketë shërbyer si një hap i parë për të hedhur dritë sadopak mbi vetëpërshkrimin dhe vetëperceptimin që Nënë Tereza kishte për personin e saj dhe aktivitetin e saj bamirës.

Referenca

[1] Gjatë analizës së librit në fjalë jemi mbështetur në botimin italisht të titulluar: “Madre Teresa: Sii la Mia Luce”, Bur Saggi (Milano 2007).

[2] Nënë Tereza ka kërkuar vazhdimisht prej konfesorëve apo udheheqësve të saj shpirtërore që të digjinin ose shkatërronin letrat që ajo u dërgonte. Disa prej atyre ajo arriti t'i shkatërronte me duart e saj pas vdekjes së personave të cilëve ajo ua kishte dërguar letrat. Megjithatë, një pjesë e mirë e tyre mbeten të paprekura dhe pikërisht falë këtyre letrave ne arrijmë të njoftohemi për vokacionin e saj dhe mundimet e saj shpirtërore. Për më shumë shih Kolodiejchuk, po aty, fq. 27

[3] Malcom Muggeridge, “Something Beautiful for God”, fq. 84, cituar në Kolodiejchuk, fq. 26.

[4] Letër që Nënë Tereza i ka shkruar kryepeshkopit Périer në 25 Janar 1947, cituar në Kolodiejchuk, fq. 27. Në një tjetër letër ajo shkruan: “Kam ardhur në Indi vetëm me shpresën për të shpëtuar shumë shpirta dhe për të arritur martirizimin”. Nënë Tereza, letër drejtuar At Van Exem, 28 Tetor 1947.

[5] Nënë Tereza në revistën “Blagovijest” [revistë katolike e Shkupit], 25 Mars, 1929, fq.3-4, cituar në Kolodiejchuk, fq. 27

[6] D.m.th. Nënë Terezën.

[7] Poezi e shkruar në serbo-kroatisht, cituar në Kolodiejchuk, fq. 27

[8] Nënë Tereza i shkruan Malcolm Muggeridge, cituar në Muggeridge, “Something Beautiful for God”, fq. 85-86.

[9]Nënë Tereza, letër shkruar shkruar Misionareve të Dashurisë, 25 Mars 1993, cituar në Kolodiejchuk, fq. 53.

[10]Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, festa e Corpus Domini, 5 Qershor 1947, cituar në Kolodiejchuk, fq. 55.

[11]Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 52.

[12]Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 347

[13]Po aty, fq. 347

[14]Po aty, fq. 351.

[15]Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, festa e Corpus Domini, 5 Qershor 1947, cituar nga Kolodiejchuk, fq. 84

[16]Po aty, fq. 84.

[17]Në një nga letrat e saj, ajo shprehet: “Jam më shumë se kurrë e vendosur që të përhap lumturinë kudo që shkoj, aromën e hareshë së Krishtit”. Nënë Tereza, letër drejtuar peshkopit Picachy, 3 Shkurt 1963. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 246.

[18]Nënë Tereza, letër dërguar peshkopit Périer, 19 Dhjetor 1953. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 162.

[19]Dekret i themelimit të Misionareve të Dashurisë, 7 Tetor 1950. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 146.

[20]Sipas Nënë Terezës zëri i Jezusit i thoshte: *Dua murgesha indiane misionare të dashurisë që do të jenë zjarri im i dashurisë ndër të varfërit, të sëmurët, ata që janë në prag të vdekjes, fëmijët e rrugëve. Dua që të dërgosh të varfërit drejt meje dhe që motrat të ofrojnë jetët e tyre si viktime të dashurisë Sime dhe t'i dërgojnë këto shpirtra drejt Meje. E di që je personi më i paaftë, më i dobët dhe më mëkatar, por pikërisht se je kështu dëshiroj të të përdor për madhështinë Time! A do të refuzosh?* Nënë Tereza, leter drejtur kryepeshkopit Périer, 3 Dhjetor 1947. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 107-108.

[21]Nënë Tereza, leter drejtur kryepeshkopit Périer, 3 Janar 1947. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 62.

[22]Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, Festa e Corpus Domini, 5 qershor 1947. Cituar nga

Kolodiejchuk, fq. 87.

[23]Nënë Tereza në revistën “Blagovijest” [revistë katolike e Shkupit], 25 mars, 1929, fq.3-4, cituar në Kolodiejchuk, fq. 27

[24]Nënë Tereza, letër drejtuar kardinalit dhe prefektit të kongregacionit të shenjtë të religjiozëve, 7 shkurt 1948. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 125.

[25]Po aty.

[26] Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, festa e Corpus Domini, 5 qershor 1947, cituar nga Kolodiejchuk, fq. 84

[27] Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, 13 qershor 1947. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 60.

[28] Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, Festa e Corpus Domini, 5 qershor 1947.

[29] Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, 13 qershor 1947. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 60.

[30] Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, 3 dhjetor 1947. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 110,

[31] Shih Gavin D'Costa, "Christianity and World Religions: Disputed Questions in the Theology of Religions" (Wiley-Blackwell, 2009), fq. 25-26. Për më shumë rreth ekskluzivizmit shih edhe Daniel Strange, "Exclusivism: Indeed Their Rock is Not like Our Rock", në "Christian Approaches to Other Faiths" ed. Alan Race & Paul M. Hedges, (SCM Press 2008), fq. 17-36; si edhe Francis A. Sullivan, "Salvation Outside the Church: Tracing the History of the Catholic Response", (Wipf & Stock Pub 2002), fq. 123-141.

[32] Siç shprehet edhe katekizmi i kishës katolike i vitit 1997: "I gjithë shpëtimi vjen prej Krishtit, që është Koka, përmes Kishës, që është trupi i tij". Catechism of the Catholic Church (USCCB Publishing; 1st, 1997) §§846-848.

[33] Shih Nostra Aetate: Deklaratë rreth marrëdhënies së Kishës me fetë e tjera http://www.vatican.va/archive/hist_councils/ii_vatican_council/documents/vat-ii_decl_19651028_nostra_aetate_en.html

[34] Shih "Ad Gentes: Rreth aktivitetit misionar të Kishës" nr. 11, http://www.vatican.va/archive/hist_councils/ii_vatican_council/documents/vat-ii_decree_19651207_ad-gentes_en.html

[35] Shih "Ad Gentes: Rreth aktivitetit misionar të Kishës" nr. 9, http://www.vatican.va/archive/hist_councils/ii_vatican_council/documents/vat-ii_decree_19651207_ad-gentes_en.html

[36] Shih "Lumen Gentium: Kushtetuta dogmatike mbi Kishën", përkth. Nga Imzot Nikë Prela, Ipeshkëv në "Dokumentet Konciliare", (Botime Drita 1992), fq. 21.

[37] Po aty, nr. 16, fq. 21.

[38] Lumen Gentium nr. 16. Fq. 21.

[39] Sipas Nënë Terezës, vetë zëri i Jezusit i kishte thënë: "Ka shumë murgesha që kujdesen për personat e pasur dhe të aftë, por për të varfërit e mi nuk ekziston asbotisht askush. Janë ata të cilët dëshiroj fuqishëm dhe i dua". Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, Festa e Corpus Domini, 5 Qershor 1947. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 87

[40] Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, festa e Corpus Domini, 5 Qershor 1947, cituar nga Kolodiejchuk, fq. 84

[41] Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, 13 Janar 1947. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 61.

[42] Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, 13 Janar 1947. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 61.

[43] Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, festa e Corpus Domini, 5 Janar 1947. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 84.

[44] Përzgjedhja e veshjes indiane për misionin e saj ishte për Nënë Terezës një urdhër të cilin ajo pohonte se e kishte marrë drejtpërsëdrejti nga Krishti, i cili i kishte thënë: “Do të veshësh rroba të thjeshta indiane...Rroba që vesh tani është e shenjtë sepse është simboli im. Sari jot do të bëhet i shenjtë sepse do të jetë simboli Im”. Nënë Tereza, letër drejtuar kryepeshkopit Périer, 13 Janar 1947. Cituar nga Kolodiejchuk, fq. 61.

[45] Në lidhje me rastet ku gjatë letrave të saj Nënë Teresa përshkruan gjendjen e saj të errësirës shpirtërore, nga ku kemi marrë edhe përshkrimet e lartpërmendura, shih Kolodiejchuk, po aty, fq. 162, 165, 170, 171, 181, 190, 193, 194, 200, 2010, 216, 221, 228, 239, 248, 251, 255, 275, 310.

[46] Shih, Kolodiejchuk, po aty, fq. 195.

[47] Shih Kolodiejchuk, po aty, fq. 200-201.

[48] Nënë Tereza, letër drejtuar At Neunerit, me shumë mundësi e shkruar në vitin 1961, cituar nga Kolodiejchuk, fq. 217. Në një tjetër letër shkruar At Neunerit në 12 maj 1962 Nënë Tereza përshkruan mundimin e saj të brendshëm në kryerjen e adhurimeve: “Sa e ftohtë, e zbrazët dhe e mbushur me dhimbje është zemra ime. Kungimi i Shenjtë, Meshja e Shenjtë, të gjitha realitetet e shenjta të jetës shpirtërore, të jetës së Krishtit në mua, janë të gjitha kaq të zbrazëta, të ftohta dhe kaq të padëshiruara”. Nënë Tereza, letër drejtuar At Neuner, 12 Maj 1962, cituar në Kolodiejchuk “Po aty”, fq. 239. Në 8 Janar të 1965 ajo i shpreh sërish Atit Neuner gjendjen e saj shpirtërore, duke thënë: “Vetmia është kaq e madhe, si në brendësi ashtu edhe për së jashtmi... Një ferri ekziston, ai duhet të jetë ky. Sa e dhimbshme është të jetosh pa Zot. Asnjë lutje, s'ka besim, s'ka dashuri”. Nënë Tereza, letër drejtuar At Neuner, 8 Janar 1965, cituar nga Kolodiejchuk, po aty, fq. 255

[49] Shih Nënë Tereza, letër drejtuar At Neuner-it, me shumë mundësi shkruar në vitin 1961, cituar nga Kolodiejchuk, fq.217; Nënë Tereza, letër drejtuar Jezusit, pa datë, cituar nga Nënë Tereza, letër drejtuar At Neunerit me shumë mundësi shkruar në vitin 1961, cituar nga Kolodiejchuk, fq. 196.

[50] At Kolodiejchuk, “Po aty”, fq. 225 ishte i mendimit se përvoja e Nënë Terezës ishte e ndryshme nga ajo e natës së errët të shpirtit, ndërsa të tjerë si Zagano & Gillspie, “Embracing Darkness”, janë të mendimit se përvoja e saj përputhet plotësisht me karakteristikat e konceptit mistik të natës së errët të shpirtit.

[51] Siç shprehet edhe vetë Shën Gjoni i Kryqit “Për arsye se drita dhe urtësia e kësaj soditjeje është shumë e ndritshme dhe e pastër, dhe shpirti në të cilin ajo shkëlqen është i errët dhe i papastër, atëherë njeriu ndjen vuatje të thella në marrjen e saj. Saint John of Cross, “*Dark Night*”, II: 6.4.

[52] Në lidhje me fenomenin e “natës së errët të shpirtit” apo “natës së errët të shqisave” jemi mbështetur kryesisht në Kolodiejchuk, po aty, fq. 33-34; Phyllis Zagano & C. Kevin Gillspie,

“Embracing Darkness: A Theological and Psychological Case Study of Mother Teresa”, në Spiritus: A Journal of Christian Spirituality, Volume 10, Number 1, Spring 2010, fq. 52-75 si edhe Kevin Culligan, “The Dark Night and Depression” in Carmelite Prayer: A Tradition for the 21st Century (NY & Mahwah: Paulist Press), 119–138; Egan, Keith J, PhD, ToCarm , “Mother Teresa’s Dark Night”, Spiritual Life; Spring 2014; 60, fq. 3-11.

[53] Shih dëshminë e dhënë nga At Neuner në Kolodiejchuk, po aty, fq. 220-221.

[54] Nënë Tereza, letër drejtuar At Neuner-it, me shumë gjasa me datë 11 prill 1961. Cituar në Kolodiejchuk, po aty, fq. 220

[55] Nënë Tereza, letër drejtuar motrave të saj, në vitin 1961, Cituar në Kolodiejchuk, po aty, fq. 227. Per idenë e errësirës shpirtërore si mjet identifikimi me të varfërit shih edhe Kolodiejchuk, po aty, fq. 222, 282.

[56] Shih Kolodiejchuk, po aty, fq. 256.

[57] Nënë Tereza i udhëzonte motrat e saj misionare që në raste vështirësie të bënin lutjen e mëposhtme: “Dëshirj të jetoj në këtë botë që është kaq larg nga Zoti, që është larguar kaq shumë nga drita e Jezusit për të ndihmuar [të varfërit], për të marrë mbi mua diçka nga vuajtja e tyre”. Shih Kolodiejchuk, po aty, fq. 227

[58] Nënë Tereza, letër drejtuar motrave të saj, në vitin 1961, Cituar në Kolodiejchuk, po aty, fq. 227.

[59] At Neuner, “Mother Teresa’s Charism”, “Review for Religious”, 5 (2001), fq.484-485. Cituar në Kolodiejchuk, “Po aty”, fq. 220,

[60] Siç shprehet edhe At Kolodiejchuk: “Vuajtja në terr e bashkoi në mënyrë misterioze kaq pazgjdhshëmrisht me Dhëndrin e saj të kryqëzuar saqë Ai u bë i vetmi ‘objekt i mendimeve dhe afeksioneve të saj, objekti i bisedave të saj dhe modeli i saj i jetës’. At Kolodiejchuk, “Po aty”, fq. 340-341.

[61] Nënë Tereza, letër drejtuar motrave të saj misionare, Korrik 1961. Cituar nga Kolodjuchk fq. 227.

[62] Kjo shprehje i referohet vetë Jezusit. Në Ungjillin sipas Gjonit thuhet se Jezusi ka thënë: “Unë jam buka e jetës; kush vjen tek unë nuk do të ketë më kurrë uri dhe kush beson në mua, nuk do të ketë më kurrë etje” (Gjoni 6:35).

[63] Nënë Tereza, fjalim mbajtur në Institutin Regina Mundi të Romës, në 20 dhjetor 1991. Cituar nga Kolodjuchk, fq. 291.

[64] Nënë Tereza, letër drejtuar At Neuner, në 6 mars 1962. Cituar nga Kolodjuchk, fq. 236.

[65] Ideja e të dhënit gjithçka Jezusit dhe të mos refuzuarit atij asgjë përbënte kushtin privat që Nënë Tereza kishte marrë në vitin 1942 dhe që luajti një rol qendrorë në punën e saj misionare. Shih Kolodiejchuk, po aty, fq. 39.

Bibliografi

- “Dokumentet Konkiliare”, përkth. Nga Imzot Nikë Prela, Ipeshkëv, (Botime Drita 1992).

- Brian Kolodiejchuk , “Madre Teresa: Sii la Mia Luce”, Bur Saggi (Milano 2007).
- Catechism of the Catholic Church (USCCB Publishing; 1st, 1997).
- Daniel Strange, “Exclusivism: Indeed Their Rock is Not like Our Rock”, në “Christian Approaches to Other Faiths” ed. Alan Race & Paul M. Hedges, (SCM Press 2008).
- Egan, Keith J, PhD, ToCarm , “Mother Teresa’s Dark Night”, Spiritual Life; Spring 2014; 60, fq. 3-11.
- Francis A. Sullivan, “Salvation Outside the Church: Tracing the History of the Catholic Response”, (Wipf & Stock Pub 2002).
- Kevin Culligan, “The Dark Night and Depression” in Carmelite Prayer: A Tradition for the 21st Century (NY & Mahwah: Paulist Press), 119–138.
- Phyllis Zagano & C. Kevin Gillspie, “Embracing Darkness: A Theological and Psychological Case Study of Mother Teresa”, në Spiritus: A Journal of Christian Spirituality, Volume 10, Number 1, Spring 2010, pp. 52-75
- Shih Gavin D’Costa, “Christianity and World Religions: Disputed Questions in the Theology of Religions” (Wiley-Blackëell, 2009).

Date Created

02/09/2016

Author

erasmusi